

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË LLOJEVE TË MBROJTURA TË
BIMËVE/FLORËS DHE KAFSHËVE/FAUNËS TË VENDIT**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektvendimi është të miratojë listën e llojeve të mbrojtura të bimëve/florës dhe kafshëve/faunës të vendit tonë, në përputhje kjo me kuadrin ligjor kombëtar për mbrojtjen e biodiversitetit, si dhe me konventat përkatëse ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

Miratimi i këtij projektvendimi ka si objektiv plotësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për biodiversitetin.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi që paraqesim për shqyrtim dhe miratim është planifikuar në matricën analitike të projektakteve për vitin 2021 dhe është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave për fushën e veprimtarisë së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për mbrojtjen e faunës së egër dhe biodiversitetit në Shqipëri. Miratimi i këtij projektvendimi kontribuon gjithashtu në zbatimin e masave të parashikuara në Dokumentin e Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit për Shqipërinë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektvendim do të kontribuojë në mbrojtjen e biodiversitetit, ekosistemeve dhe, vecanërisht, të llojeve të bimëve/lorës dhe kafshëve/faunës të vendit tonë që do vihen në mbrojtje.

Llojet që do vihen në mbrojtje nëpërmjet këtij akti, rrjedhin nga llojet e mbrojtura të konventave që vendi ynë ka nënshkruar dhe është palë në to, ku rendisim Konventën “Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Evropës” (Konventa e Bernës), Konventën “Për mbrojtjen e llojeve migratore” (CMS), si dhe Konventën “Mbi tregëtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër” (CITES).

Pra do përfshihen në listën e llojeve të mbrojtura të vendit tonë, paraqitur në Shtojcën I, ato lloje që gjenden në vendin tonë dhe që janë pjesë e: (i) Konventës së Bernës - llojeve të Aneksit I, II dhe III të sajë; (ii) Konventës CMS – llojeve të Anekseve I dhe II të sajë; (iii) Konventës CITES – llojeve të Aneksit I të saj.

Nuk do përfshihen në këtë listë, ato lloje të Konventës së Bernës të përfshira në Aneksin I të saj (Lloje të mbrojtura të florës) të cilat janë përfshirë në VKM nr. 804, datë 4.12.2003 “Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare, që vihen në mbrojtje”.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me kuadrin ligjor kombëtar të fushës së mbrojtjes së natyrës dhe hartohet në

zbatim të pikës 2 të nenit 20, të ligjit nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar. Ai gjithashtu, sikurse e përmendëm dhe më lart, do jetë në përputhje e zbatim dhe të detyrimeve të konventave të fushës së natyrës në të cilat vendi ynë ka aderuar e është palë në to.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon transpozimin e ndonjë dispozite të Acquis së BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është konceptuar në 2 pika dhe një shtojcë.

Sqarojmë së pari terminologjinë e përdorur në projektvendim, ku jemi shprehur me të dy emërtimet për llojet e mbrojtur të vendit, ‘bimë/florë’ dhe ‘kafshë/faunë’. Megjithëse në disa raste në ligjin “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar, si psh. në nenin 20, nga i cili buron ky projektvendim, por dhe më poshtë, psh. në nenin 23, 25, etj, janë përdorur termat ‘kafshë’ dhe ‘bimë’, është në frymën e legjislacionit të natyrës e të biodiversitetit sot, që të përdoren emërtimet ‘faunë’ dhe ‘florë’. Kështu psh., është cilësuar ligji nr. 9021, datë 6.3.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër”(CITES)”, ligji nr. 9867, datë 31.1.2008, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregëtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër”, i ndryshuar, ligji nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, i ndryshuar, etj. Me këtë emërtim ka dalë gjithashtu Urdhëri nr. 1280, datë 20.11.2013, “Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës së egër” (që ka dalë në zbatim të nenit 22,

pika 5, të ligjit “Për mbrojtjen e biodiversitetit”). VKM e sipërcituar nr. 804, datë 4.12.2003 “Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare, që vihen në mbrojtje”, etj.

Mbi këtë bazë, për të qenë në një linjë si me terminologjinë e nenit 20, ashtu dhe me praktikën e shumëpërdorur sikurse cituam më lart, kemi paraqitur në këtë projektvendim të dy termat, ‘bimë/florë’ dhe ‘kafshë/faunë’, si në titull të tij, ashtu dhe në brendi të aktit dhe në shtojcën e tij.

Lidhur me përmbajtjen e aktit, pika 1 e projektvendimit miraton listën e llojeve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër të vendit tonë.

Ndërsa pika 2 identifikon institucionet që ngarkohen me zbatimin e vendimit.

Shtojca I, që i bashkëlidhet dhe është pjesë e këtij akti, paraqet listën e llojeve të mbrojtura të florës dhe të faunës së egër të vendit.

Në Shtojcë, në kollonën e parë të saj, janë paraqitur llojet që do mbrohen, emërtuar në gjuhën e tyre shkencore, në latinisht, sikurse janë paraqitur (me ‘bold’) edhe emrat e Rendeve dhe Familjeve ku bëjnë pjesë këto lloje.

Në kollonën e dytë të Shtojcës, janë paraqitur emrat që zakonisht përdoren në shqip për këto lloje, duke lënë bosh në tabelë (pa emër), ato lloje për të cilët akoma nuk ka një emër në shqip.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Ministria përgjegjëse për mjedisin, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Bashkitë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

**IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE
SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektvendimi nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

MINISTËR

Mirela KUMBARO FURXHI



Relacion shpjegues për projektvendimin: "Për miratimin e listës së llojeve të mbrojtura të bimëve/lorës dhe kafshëve/faunës të vendit"